



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË
SHOQËRIA PËRMBARIMORE "CORRECTOR" SH.P.K.

Nr. 13570 Prot.
Nr. Dosje 1311

Tiranë, më 05/12/2019

URDHËR

"Për vendosjen e sekuestros mbi kuotat e debitorit"

Drejtuar: **QENDRËS KOMBËTARE TË REGJISTRIMIT, TIRANË**

Për dijeni: **Shoqëria "ALB KORÇA 2002" sh.p.k me NIPT K34004003T**
Adresë: Pojan, Zemblak, Lagjja Qender, Rruga Nacionale, Km I, Korçë

Unë Armels Lole përbarues gjyqësor pranë Shoqërisë CORRECTOR sh.p.k., pasi studiova materialet e dosjes përbarimore Nr. 1311, bazuar në Vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane – Nr. 10457 Vendim, datë 18/12/2018,

KONSTATOVA:

Se më datë 11/11/2019 është lidhur kontrata e shërbimit midis shoqërisë përbarimore Corrector sh.p.k dhe kreditorit Tranzit Shpk, me objekt ekzekutimin e Titullit Ekzekutiv – Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë Nr. 10457 Vendim, datë 18/12/2018 me palë dhe objekt:

- **Kreditor:** Tranzit shpk (Kontrate datë 21/10/2016)
- **Debitorë:** Shoqëria "ALB KORÇA 2002" sh.p.k me NIPT K34004003T
- **Objekti:** Pagesë detyrimi

Për ekzekutimin e Urdhrit të Ekzekutimit, duhet të kryhet vënia e sekuestros mbi çdo pasuri të debitorit me qëllim shlyerjen e detyrimit ndaj kreditorit.

Për sa më sipër, si dhe në zbatim të neneve 519, 527, 560, 563 e në vijim të K.Pr.Civile si dhe të Ligjit Nr.26/2019 "Për Shërbimin Përbarimor Gjyqësor Privat"

URDHËROJ:

1. Vendosjen e sekuestros mbi kuotat e subjektit:

- **"ALB KORÇA 2002" sh.p.k me NIPT K34004003T, me Seli: Korçë, Pojan, Zemblak, Lagjja Qëndër, Rruga Nacionale, Km I-rë.**

duke ndaluar disponimin ose tjetërsimin e kuotave të debitorit, si dhe ushtrimin e të drejtave që rrjedhin nga këto kuota;

2. Për veprimet apo mosveprimet tuaja, na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor;
3. Për personat që bëhen pengesë, do të aplikohet sanksioni i gjobës në shumën 50.000 lekë në zbatim të nenit 606 të K.Pr.Civile si dhe kallëzimi për ndjekje penale në zbatim të nenit 320 të K.Penal.
4. Kundër detyrimit që përcakton ky urdhër, palët e interesuara kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga njoftimi.

SHOQËRIA "CORRECTOR" SHPK
PËRMBARUESI GJYQËSOR
ARMELS LOLE

